

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS,
TË MBAJTUR MË 29 JANAR 2004

PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 29. 01. 2004. GODINE

JANAR – JANUAR
2004



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Odën Ekonomike të Kosovës (2003/33),
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për barazi gjinore (2003/29),
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit kundër diskriminimit (2003/28),
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për materialin fidanor (2004/1),
6. Propozimi i rendit të ditës për Seancën tjetër plenare të 5 shkurtit 2004:
 - 6.1 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shëndetësi (2003/31),
 - 6.2 Shqyrtimi i dytë i Projektlegjislacionit për bashkëpunim me Tribunalin Panel të Hagës.

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање записника са претходне седнице,
2. Друго разматрање Нацрта закона о Привредној комори Косова (2003/33) ,
3. Друго разматрање Нацрта закона о Полниј равноправности (2003/29),
4. Друго разматрање Нацрта закона против дискриминације (2003/28),
5. Прво разматрање Нацрта закона о садном мареријалу (2004/1),
6. Предлог дневног реда за пленарну седницу за 5. фебруар 2004:
 - 6.1 Друго разматрање Нацрта закона о здравству (2003/31),
 - 6.2 Друго разматрање Нацрта закона о сарадњи са Кривичним Трибуналом у Хагу.



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

AGENDA

1. Approval of the minutes from the previous meeting,
2. Second reading of the Draft Law on Economical Chamber of Kosovo (2003/33),
3. Second reading of the Draft Law on Gender Equality (2003/29),
4. Second reading of the Draft Law on Anti Discrimination (2003/28),
5. First reading of the Draft Law on Propagation Material (2004/1),
6. **Proposal of Agenda for the Plenary Session on February 5, 2004:**
 - 6.1 Second reading of the Draft Law on Health (2003/31),
 - 6.2 Second reading of the Draft Legislation regarding to cooperation with Tribunal of Hag.

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 29 JANAR 2004

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës, u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës – Prishtinë.

Seancën e kryesoi Akademik Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Bashkëkryesues Oliver Ivanoviq, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Seanca filloi punën në orën 10,00.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes dhe mirë se keni ardhur në Seancën e rregullt të Parlamentit tonë.

Dhe sa për njoftim – kjo do të jetë seanca e fundit në këtë ndërtesë. Dhe publikisht, edhe pse do të kërkoj që me kryetarin e komunës, që aq gjatë na ka duruar dhe na ka krijuar kushte pune - ta falënderoj, por dua edhe publikisht stafin udhëheqës të Kuvendit Komunal, kurse në një pauzë – besoj se edhe një kafe do ta kam shancën me të me pirë dhe do të vazhdojmë besoj në kushte më të mira pune.

Materialet shpresoj se janë shpërndarë me kohë.

Fillojmë menjëherë me punë. Është paraqitur, sipas marrëveshjes që e kemi me shkrim për rendin e ditës meqë nuk arritëm, dhe kjo vlenë vetëm për rast të asaj dite, zoti Rangjell Nojkiq për rendin e ditës, prandaj duhet ta rrespektojmë atë. Urdhëroni zoti Nojkiq.

RANDJEL NOJKIĆ:

Dame i gospodo, Radno predsedništvo,

Ja sam mislio da ćete vi da postavite pitanje usvajanja dnevnog reda, jer i prema važećim Poslovniku i onaj koji nije važeći poslovnik trebalo da se stavi ova tačka dnevnog reda s obzirom da na prošloj sednici koja je završena mi nismo raspravljali o dnevnom redu i praktično dnevni red za ovu sednicu poslanici nisu usvojili. Zato sam smatrao pre svega vrlo važnim da vi to postavite i da se potvrdi dnevni red odnosno da usvojimo dnevni red jer, kao što sam već rekao, na prošloj sednici nije on usvojen. To je prva stvar.

Druga stvar. Ja sam pretprošle sednice pokrenuo inicijativu za dnevni red u nekoj od narednih sednica i mislim da takodje da je bilo valjano da nam date odgovor odnosno da mi date odgovor šta je bilo sa tom mojom inicijativom koju sam ja dao.

I, kad sam već izišao za govornicom, samo da vam kažem da je juče bilo Udruženje kidnapovanih i nestalih Srba sa Kosova «i Metohije» i oni su hteli sa vama da se sastanu, ali pošto iz opravdanih ili neopravdanih razloga niste to mogli, ja sam u obavezi da vam dam pismo koje su oni hteli vama da uruče i sa vama da porazgovaraju. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Unë do të përgjigjem vetëm në këtë të fundit.

Më është paraqitur kërkesa gojore e kryetares së Komisioni tonë parlamentar për këtë çështje. Unë kam pasë një agjendë të caktuar paraprakisht. Do të thotë më është paraqitur në ditën kur është mbajtur takimi. Megjithatë, për shkak të ndiejshmërisë së problemit, nuk e di ja ia kanë përcjell drejt kryetares së Komisionit, i kam thënë – një kohë shumë të shkurtër mund ta ndaj me pranuar kryetaren e Komisionit dhe nënkryetarët të Komisionit tonë dhe kryetarin, apo kryetaren dhe nënkryetarin e atij grupacioni.

Përgjigje tjetër nuk kam pasë. Do të thotë, unë kam dashur që të jem me ta. Nuk e kam refuzuar, dhe do të jem sepse në mbledhje që kam qenë me Komisionin, që kam asistue në një mbledhje - kam shpreh gatishmërinë time për të marrë pjesë.

Prandaj, nuk ka asnjë prapavij tjetër, por unë e kam konsideruar që nuk keni pasë kohë aq shpejt me ardhë. Do të vijmë herën tjetër, prandaj nuk kam çka tjetër lidhur me këtë. Ju falemnderit.

Jo, s'ka nevojë të paraqiteni. Unë e përkrahi punën e komisioneve gjithmonë dhe jam me komisionin, prandaj kjo ishte përgjigja.

Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar, dhe besoj se do të shkojmë në mënyrën e rëndomt me shkrim, në qoftë se ndokush ka vërejtje dhe kështu të procedohet.

Dhe, kalojmë menjëherë në shqyrtimin e dytë të Projektligjit për Odën Ekonomike të Kosovës.

Më lejoni t'i jap vetëm disa informata lidhur me këtë.

Materiali iu është shpërndarë deputetëve me kohë.

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë më 11 dhjetor 2003.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit ia kanë bërë rekomandimet si vijon:

1. Komisioni për gjyqësi, legjislacion dhe kornizë kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji e ka bazueshmërinë në Kornizën kushtetuese.
2. Komisioni për buxhet ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet nuk përmbajnë implikime financiare dhe buxhetore.
3. Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve ka vlerësuar se me këtë ligj nuk cenohen të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
4. Amendamentet e Grupit Parlamentar të Koalicionit "Kthimi" dhe të deputetit Bedri Selmani në këtë Projektligj janë shqyrtuar nga Komisioni funksional.
5. Komisioni për ekonomi dhe financa, si Komision funksional dhe referues, Kuvendit i ka paraqitur Raportin dhe rekomandimet me amendamente.

Ju lutem, radha e diskutimeve është:

- propozuesi i Projektligjit; kryeministri ose ministri përkatës;
- kryetari i Komisionit funksional referues;
- kryetarët e komisioneve kryesore;
- kryetarët e grupeve parlamentare;
- anëtarët e Kryesisë; dhe
- deputetët sipas paraqitjes së tyre dhe rendit të caktuar nga kryetari i Kuvendit.

Prandaj, unë hap debatin...

Ju lutem, zoti Dugolli ose zoti Luzha - kjo ishte vetëm hyrja, ndërsa amendamentet e Komisionit funksional, e mora informatën, që i keni të gjithë.

Në qoftë se nuk i keni, atëherë ndërron çështja. Po ashtu janë marrë vesh... Do të thotë tash të gjitha komisionet i harmonizojnë dhe Komisioni funksional është ai... Kjo është marrëveshje në nivel të Parlamentit.

BEDRI SELMANI:

Zotri kryetar, zonja e zotrinj deputet, zotri ministra,

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Odën Ekonomike të Kosovës, duke u bazuar në Raportin dhe Rekomandimet e Komisionit për financa dhe ekonomi, si Komision funksional, është plotësisht i gabueshëm nga aspekti profesional dhe funksional në kushtet dhe rrethanat e fillimit të funksionimit të një ekonomie të mirëfillt të tregut në Kosovë.

Në Raportin dhe në amendamentet e Komisionit vërehet qartë mungesa e informatave themelore për domosdoshmërinë e funksionimit të Odës si organizatë e pavarur profesionale – afariste, që në mënyrë unike përparon, përfaqëson dhe i harmonizon interesat e përbashkëta të anëtarëve, siç janë: ndërmarrjet, shoqatat dhe organizatat tjera profesionalo-shkencore para institucioneve të Kosovës dhe organeve tjera në vend dhe jashtë vendit.

Ky Komision, duke mos kuptaur këtë konceptualitet të detyrës që do ta ketë Oda me këtë ligj, ata që në amendamentin e parë të propozuar bëjnë gabimin themelor, duke propozuar që të ndryshohet emërtimi i Projektligjit dhe të quhet, sipas tyre – projektligji për Odën ekonomike të Kosovës dhe asociacioneve tjera të organizimit të biznesit në Kosovë, dhe me këtë - Komisioni funksional bën gabim dhe tërë Projektligjin për Odën Ekonomike të Kosovës e ka vënë në gjendje paradoksale dhe të pakuptueshme për këto arsye:

Nën një. E barazon Odën si organizatë të pavarur dhe domosdoshmërinë e unitetit të saj me shoqatat e biznesit, të cilat janë organizata joqeveritare.

Kjo është e pakuptueshme dhe po që se gabohet e aprovohet ky ndryshim i emërimit të këtij Projektligji, kjo nuk do të funksionojë në strukturën e amendamenteve të Projektligjit për Odën Ekonomike të Kosovës. Dhe, nga kjo shihet se Komisioni jo vetëm që e ndërron emërtimin, pas leximit të parë të Projektligjit për Odën, por ai në këtë rast e dezorganizon tërë strukturën e unitetit të Projektligjit i cili si i tillë humbë rëndësinë e funksionalitetit të Odës që ajo të funksionojë si një Odë Ekonomike e Kosovës unike që është mëse e domosdoshme në kushtet e fillimit të ekonomisë së tregut në vendin tonë.

Nën dy. Komisioni, si duket, nuk e ka kuptaur rolin që duhet ta luajë Oda Ekonomike e Kosovës në funksionimin e sistemit ekonomik të vendit si subjekt që përparon, përfaqëson dhe harmonizon interesat e përbashkëta dhe bën lidhmërinë e domosdoshme në mes dy nënsistemeve: atij makroekonomik dhe mikroekonomik dhe, me këtë të bëjë përpjekje të sigurojë unitetin e sistemit ekonomik në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Kjo nuk mund të arrihet me shumë oda, e aq më tepër kur tentohet të barazohet Oda dhe shoqatat e biznesit. Kjo, në të gjitha vendet e Unionit Evropian është organizim unik i një ode që përfaqëson interesin e ndërmarrjeve dhe asociacioneve tjera në nivel të ekonomisë së këtyre vendeve.

Këtë gabim të Komisionit funksional e kanë përcjellë edhe komisionet tjera, duke besuar gjithëherë se Komisioni funksional është i pagabueshëm.

Mirëpo, këtë herë, me të vërtetë Komisioni funksional ka gabuar.

Dhe, nën tre. Çështje tjetër që vëhet në pikëçështje në këtë Projektligj për Odën është mënyra e anëtarësimit dhe e financimit për sigurimin e mjeteve. Janë dy pikëpamje lidhur me këtë. Pikëpamja anglo-saksone ose mënyra vullnetare e anëtarësimit në odë dhe pikëpamja kontinentale ose evropiane e obligueshme e organizimit dhe e anëtarësimit në odë.

Komisioni funksional dhe komisionet tjera, nën ndikimin e paarsyeshëm, janë përcaktuar për pikëpamjen anglo-saksone. Pra, në mënyrën vullnetare të anëtarësimit dhe të financimit. Kjo është gabim, sepse duke u bazuar në atë që e thamë më parë, Oda Ekonomike e Kosovës nuk do të mund të kryejë rolin dhe funksionin e saj në qoftë se nuk i siguron mjetet e duhura financiare. Oda nuk do të ketë mundësi t'i sigurojë dhe t'i paguajë ekspertët nga lëmitë e ndryshme që do të paraqitëshin forcën e vetme intelektuale dhe në mënyrë unike do të ndihmonin në zhvillimin e interesit ekonomik të ndërmarrjeve dhe shoqatave anëtare të Odës.

Prandaj, për këtë arsye, është e domosdoshme që anëtarësimi të jetë i obligueshëm, ashtu siç bëhet në të gjitha vendet e Unionit Evropian. Oda ekonomike në këto vende funksionon në mënyrë shumë të suksesshme, në mënyrën e obligueshme të anëtarësimit, sepse oda si e tillë në këto vende është në funksion të interesit të të gjitha ndërmarrjeve dhe organizatave tjera në ekonominë e këtyre vendeve dhe si e tillë në këto vende është një dhe unike.

Po ashtu, në të gjitha vendet me ekonomi në transicion, si në Evropën Lindore, ashtu edhe në atë Qendrore, Juglindore janë duke u aplikuar mënyrat e obligueshme të anëtarësimit dhe financimit.

(Ndërhyrje e kryetarit: Nëse mundeni, përmbylleni, ju lutem)

Të gjitha këto vërejtje, unë i kam dhënë përmes amendamenteve në Projektligjin për Odën Ekonomike të Kosovës, të cilat Komisioni funksional i ka anashkaluar në mënyrë të papërgjegjshme dhe si duket fare nuk i ka analizuar amendamentet e dhëna.

Prandaj, për këtë propozoj që me të gjitha këto argumente që u dhanë më parë, të mos përkrahet Raporti i Komisionit funksional sepse është i gabuar, dhe propozoj që të procedohet dhe të votohet për çdo amendament veç e veç në mes projektpropozuesit të ligjit dhe amendamenteve të cilat janë propozuar nga ana ime. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Shefat e grupeve, po. Urdhëro, si kryetar i Komisionit... A je kryetar apo... Po urdhëroni.

FATMIR REXHEPI:

I nderuar kryetar, të nderuar deputetë,

Komisioni për ekonomi dhe financa, duke parë rëndësinë e këtij Projektligji që i është ofruar Kuvendit ka pasë debatet publike, ka marrë interesimet edhe të komunitetit të biznesit edhe të të gjithë përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme në këtë debat dhe në kuadër të tyre ka nxjerrë vlerësimet e propozimet në mënyrë që ligji për Odën Ekonomike dhe paketa e amendamenteve të bëhet e

tillë, do të thotë propozimet të cilat i keni përpara, e që do të mundësojnë një ligj i cili po ashtu mundëson pra formimin dhe organizimin e Odës Ekonomike të Kosovës dhe asociacioneve tjera në bazë të praktikave demokratike, praktikave moderne të cilat bëhen në vendet në të cilat kalojnë në transicion siç është edhe Kosova.

Ligji pra të mundësojë vendosjen e një mjedisi konkures, të bazuar në parimet e ekonomisë të tregut, si dhe funksionimin e odës dhe asociacioneve tjera. Të sigurojë pra mundësinë për shërbime cilësore dhe me shumë vlerë për anëtarët e këtyre asociacioneve. Anëtarësimin dhe metodat e financimit i përcakton ndërmarrësi me kontratë në cilindo asociacion që ai e zgjedhë vetë. Ligji mundëson pra që oda dhe asociacionet për organizimin e biznesit të Kosovës të përfaqësojnë interesat e biznesit e jo të qeverisë apo të ndonjë grupi të caktuar.

Amendamentet e Komisionit për ekonomi dhe financa mundësojnë që ligji të sigurojë alternativën dhe modelin më të përshtatshëm për organizimin e biznesit në Kosovë në hap me kohën, në hap me zhvillimin ekonomik, në hap me konkurrencën e lirë, dhe në hap me ekonominë e tregut të lirë.

Kjo është ajo përmbajtja që e përfshijnë këto amendamente në Projektligjin gjatë gjithë këtij debati, që është shqyrtuar me shumë seriozitet dhe me shumë përkushtim.

Vlerësimet për të cilat iu dha rasti të keqpërdoret foltorja këtu nga deputeti Selmani për Komisionin për ekonomi dhe financa, mendoj se ato nuk qëndrojnë të asaj natyre dhe të asaj forme çfarë i tha ai. Sepse, është e kundërta. Do të thotë, në qoftë se zotni është ekonomist, në qoftë se ai përfaqëson ose don të niset në trendet e reja atëherë le të dalë e të thotë se në ekonominë e tregut, në ekonominë kur ne po bëjmë privatizimin, kur të gjitha ndërmarrjet në Kosovë po duhet të transformohen dhe t'i përshtaten këtij trendi të zhvillimeve ekonomike dhe këtyre transformimeve - e ne dëshirojmë që të bëjmë një monopol të caktuar, t'kalojmë një tip socialist të modelit të caktuar, e cila kohë ka përendu.

Prandaj, i lutem që t'i vështrojnë gjërat drejt sepse këto parasysh i ka patur Komisioni dhe unë mendoj se jemi në hap me trendet e caktuara, prandaj deputetët për ligjin kanë mundësinë ta vlerësojnë vetë dhe të shohin vetë se cilat janë vërtetë alternativat më të mira. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Zoti Arsim Bajrami për Grup Parlamentar. Pastaj grupi tjetër sipas madhësisë... Jo, unë po të shiqoj a po don me lyp fjalën. Me shkrue s'e ke shkrue, dhe s'po e lypë?

ARSIM BAJRAMI:

Zoti kryetar, të nderuar kolegë,

Mendoj se një fakt duhet të jetë i qartë, ne sot po bëjmë leximin e dytë. Shumë komente që po jipen tash, mendoj se janë dhënë edhe në leximin e parë kur është bërë diskutimi parimor dhe sot duhet kryesisht të bëhet leximi nen për nen dhe të shqyrtohen amendamentet.

Duke lexuar amendamentet e Komisionit funksional, unë shoh se shumë nga këto amendamente janë konceptuale dhe në fakt prekin në vetë strukturën dhe konceptin e ligjit të propozuar nga Qeveria. Për shkak se Qeveria këtu ka përcjellë një ligj për Odën Ekonomike, tani tentohet që përmes këtij ligji të rregullohen edhe asociacione tjera të biznesit.

Unë mendoj se është shumë vështirë tash, në kuadër të këtij ligji, të krijojmë një kornizë ligjore që përfshijnë edhe organizatat tjera të biznesit. Dhe, në qoftë se vërtetë ne dojmë tash përmes këtij ligji të krijojmë shumë asociacione tjera – rregullator të jetës ekonomike, atëherë shtrohet pyetja – a po diskutojmë dhe a po miratojmë ligjin në procedurë apo po bëjmë krejt ligj tjetër?

Unë pres që këtu edhe sponsoruesi i ligjit të jetë shumë më i kuartë, meqenëse edhe sponsoruesi i ligjit mund në proces - derisa ligji të votohet - të paraqesë amendamente dhe ai të skjarohet – a e ka procedur ligjin për Odën Ekonomike, ashtu siç e ka marrë në leximin e parë Kuvendi i Kosovës apo po e ndërron vetë emërtimin e ligjit? Në qoftë se ndërrohet emërtimi i ligjit, ligji ndërron në koncept dhe në krejt strukturën e ligjit.

Ne kemi marrë leximin e parë dhe e kemi miratuar në parim li ligj për Odën Ekonomike. Ashtu është miratuar nga të gjitha grupet parlamentare. Në leximin e parë ka marrë përkrahjen si ligj i tillë. Tani me këto amendamente ky nuk po na del si ligj për Odën Ekonomike, po si ligj për Odën Ekonomike të Kosovës dhe asociacionet tjera të organizimit të biznesit në Kosovë. Nuk është fjala vetëm për ndërrimin e emërtimit të ligjit, por edhe ndërrime konceptuale në krejt frymën e ligjit. Unë nuk shpresoj se Komisioni funksional ka arritur që me të gjitha amendamentet ta bëjë ligjin koherent në pajtim me titullin. Për këtë arsye mendoj se ne duhet të diskutojmë për atë ligj të cilin e kemi miratuar në parim – në leximin e parë, pra ligjin për Odën Ekonomike.

Në qoftë se dojmë me bë ligj tjetër për asociacione tjera të biznesit, presim nga Qeveria, nga Ministria përkatëse që ta sponsorizojë një ligj të tillë dhe ai të procedohet në procedurë normale.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Profesor a doni fjalën në emër të Grupit Parlamentar? Ministri e ka fjalën.

ALI SADRIU:

Të falemnderit zoti kryetar që më dhatë fjalën dhe mundësinë që ta sqaroj një çështje që ishte në proces e realisht që nuk do duhej të ishte, e realisht ka ndodhë.

Juve, të nderuar deputetë ju kujtohet se në fjalën hyrëse unë kam prezentu ligjin mbi Odën Ekonomike dhe ai është përcjellur me dy varianta: në anëtarësimin obligativ dhe në anëtarësimin vullnetar. Në fjalën time kam skjarue të gjithë çështjen që ka të bëjë me variantin e parë dhe çështjen e dytë.

T'ju përkujtoj se, nëse shkojmë me variantin e parë, pra me anëtarësimin e obligueshëm, ne jemi të detyruar të ndërrojmë Ligjin mbi menaxhimin e financave publike, një Ligj për të cilin kemi humbur shumë kohë deri sa e kemi miratuar. Ai Ligj nuk duron parafiskalitet apo kuaziinstitutcion. Ne këtë e kemi bërë sepse në Qeveri nuk kemi arritur të kemi një unitet e të shkojmë me një variantë.

Dhe, në mbledhjen e fundit të Qeverisë është marrë qëndrimi që Kuvendit t'i prezentohen dy variantat, me të gjitha elementet që e përcjellin variantin e parë dhe variantin e dytë. Dhe fjala ime si sponsorues ka qenë e natyrës së tillë. Nga kryetari i Komisionit jam njoftuar se atje ka shkue vetëm një variantë. Unë këtu kam materialin e sekretarit që tekstualisht thotë: përcillet në dy varianta, sepse ai është vendimi i Qeverisë. Komisionit i ka shkue vetëm një variantë, pra ndodhin edhe gjëra të tilla dhe ju lutem që të fillojë procedura pse ka ndodhur kjo. Është një kërkesë e imja.

Nga amendamentet që unë kam vërejtur nga Komisioni funksional, pos ndërrimit të emërimit të ligjit, nenet të cilat janë - janë plotësisht në frymën e përcaktimit të qëllimeve thelbësore të këtij ligji. Pra, unë nuk vërej se me këto amendamente do të ndërrojmë ose do të vijmë para situatave ku na implikohen ndërrime tjera, përkundrazi. Po të shkojmë në variantin e parë ne do të jemi të detyruar pra të ndërrojmë edhe frymën e ligjit. Kaq, ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit shumë. Zoti Bujar Dugolli.

BUJAR DUGOLLI:

Falemnderit. Së pari, kjo procedurë qysh ka fillue nuk është në rregull në bazë të rregullave të punës të Kuvendit. Është e paraparë që nuk lejohet debat. Këtë të gjithë e dijmë dhe sot po lejohet. Është edhe një, të them, presedan tjetër që është bërë sot. Ne i kemi amendamentet që janë ofruar për këto projektligje të cilat nuk janë të bazueshme në Rregulloren e punës të Kuvendit. Të gjithë, nëse e kanë, le të lexojnë Rregullën 34, neni 1 dhe 2 dhe do të shohin se Kuvendi duhet t'i shqyrtojë të gjitha amendamentet që janë propozuar nga grupet parlamentare, Komisioni funksional, deputetët, grupet e deputetëve dhe ne nuk kemi radhitjen e amendamenteve, siç ka qenë praktikë më herët. Dhe mendoj se ne nuk mund të bëjmë pa radhitje shqyrtimin e këtyre amendamenteve dhe nuk e dijmë se ndonjëherë ne kemi diskutue për këtë metodologji të punës që po aplikohet sot.

Prandaj, ne si Grup Parlamentar nuk do të marrim pjesë në këtë votim kështu sepse janë ngatërruar gjërat dhe kërkojmë që të kthehet metodologjia qysh është përdorur deri tash - radhitja e amendamenteve duke i përfshirë të gjitha amendamentet edhe të deputetëve, edhe të komisioneve, edhe të grupeve parlamentare, sepse sot kemi amendamente të Komisionit funksional, të deputetit Bedri Selmani dhe kemi amendamentet e Koalicionit "Kthimi" të cilat nuk e dijmë ne çfarë qëndrimi ka mbajt, cilat i ka përkrahë dhe cilat nuk i ka përkrahë Komisioni funksional.

Prandaj, për këtë arsye ne kërkojmë që kjo të hiqet sot prej procedurës dhe të aplikohet metodologjia siç e kemi pasë deri më tash. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Sabri Hamiti – Lidhja Demokratike e Kosovës.

SABRI HAMITI:

Diçka nga ajo që kisha ndërmend të them, e tha Dugolli dhe në atë pjesë e përkrahi rreth procedurës.

Mua, zoti kryesues, pak më keni hutuar sot me këtë mënyrë të zhvillimit të këtij diskutimi, se ky është diskutimi parakselansi t'leximit të parë qysh e kemi bërë gjithë, por ne jse. Me gjasë ka arsye të paarsye përtej këtyre bangave që bëhet kështu. Unë përtej këtyre bangave s'dua të bisedoj.

Nën një. Në bazë të procedurave që ne i kemi tradicionale ne duhet të kalojmë në votimin ose në mosvotimin e këtyre amendamenteve dhe të mos "shesim mend" në thojza e të mos filozofojmë kot rreth këtyre problemeve. Ne kemi punue, komisionet na kanë oforuar këtë që na kanë ofruar. Nëse kanë ofruar sende të këqia, ne s'i votojmë dhe mbaroi puna. Nuk e di pse të paragjykojmë për këto probleme.

Nëse, në kuptimin procedural është në rregull kjo që thonë, atëherë ne vazhdojmë kështu. Dokumenti thotë që ky Komision i ka pasë parasysh – në hyrje dhe lexoni në hyrje – propozimet e deputetit Bedri Selmani dhe të Koalicionit "Kthimi" dhe i ka pa – të pavlelfshme, ta zëmë – dhe nuk i ka marrë parasysh dhe nuk janë brenda. Si informatë, ne si deputetë, i kemi pasë të gjitha ato.

Për t'i dhënë fund krejt kësaj, unë mendoj që s'ka kurrfarë arsye sendin që e kemi shti në rend të ditës qe dy herë e mos ta shqyrtojmë dhe propozoj që të votojmë amendamentet sipas zakonit të përhershëm një nga një. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit profesor. Edhe Gani Prekopuca me shkrim është paraqitur, por po duket se heq dorë. Falemnderit.

Më lejoni tash të kalojmë në fazën vepruese.

Por, para se të kalojmë e të hyjmë në procedurë të votimit, dy konstatime elementare.

Unë kam pritur që Komisioni për legjislacion dhe kornizë kushtetuese do ta kundërshtojë rëndë emrin e ligjit. Parimi është gjithmonë mbështetja e komisio-

neve dhe në veçanti i e Komisionit funksional dhe do të qëndrojë mbi këtë deri sa të jetë në funksion të furnizimit me ligje cilësore dhe ligje që i duhen Kosovës.

Ligji në shqyrtimin e dytë është kundër dy parimeve themelore strategjike për të cilat është përcaktuar Kosova me institucionet në tërësi.

E para, ligji me nomenklaturën e re nuk e ka marrë përkrahjen në shqyrtimin e parë kur asnjë grup parlamentar nuk e ka kundërshtuar emërtimin si është aprovuar në shqyrtimin e parë.

E dyta, kolegë të Komisionit funksional - Përcaktimet strategjike të Kosovës janë integrimi në Bashkësinë Evropiane dhe nxjerrja e krejt gamës së ligjeve në Kosovë bëhet në atë që të jenë ligje kompatible me këto vende. Ky propozim jo vetëm që është kundër orientimeve strategjike të Kosovës, por edhe kundër orientimeve... të gjitha vendet në fqinjësi nuk kanë këso lloj... Edhe atë që na tha zoti Rexhepi – orientimet progresive u desht ta përmend një model të këtij progresi në të cilin, në shqyrtimin e parë flasim për ligjin mbi bimët shëruese dhe në shqyrtimin e dytë i fusim edhe bimët tjera.

Prandaj, është e drejtë e deputetëve të vendosin si të dojnë. Unë e ndieva obligim timin, derisa të jam në këtë funksion, gjithmonë t'i përmbahem cilësisë së punës.

Dhe kalojmë në vendosje...

Kush është për amendamentin numër 1, le ta çojë dorën?

Një, momentë pasi don ta marrë fjalën, sepse e kam përmendur Komisionin.

ARSIM BAJRAMI

Meqenëse kryetari përmendi Komisionin për çështje legislative, unë ndiej obligim për të dhënë një shpjegim.

Meqenëse në mënyrë të tërthortë u thirra me dalë këtu, unë dola për shkak se kryetari përmendi se Komisioni për legjislativ nuk ka qëndrim. Unë, më duket isha shumë i kuartë herën e parë. Unë thash se Qeveria, ministria përkatëse ka propozuar në leximin e parë Projektligjin për Odën Ekonomike. Si i tillë ky Projektligj është miratuar në parim nga të gjitha grupet parlamentare. Në leximin e dytë objekti i këtij ligji ndryshon, për shkak se nuk rregullon vetëm çështjen e odave ekonomike por edhe të asociacioneve tjera të biznesit. Për mua

është krejtësisht jorelevante çka ka menduar Qeveria. Për mua është relevant versioni që ka dhënë zyrtarisht Qeveria. Në tekstin që e kemi marrë në deputetët, ne s'kemi pasë njëherë variantin e dytë. Në tekst është një variant i parë. Në qoftë se Qeveria ka menduar se ky ligj ka implikime në ligjet tjera, atëherë është dashur ato gjëra seriozisht t'i ketë në atë fazë dhe ligjin mos ta bie në Kuvend. Jo tash në këtë fazë me na treguar – ky ligj në këtë variantë në qoftë se miratohet - ka implikime në ligjet tjera. Mendoj se Qeveria duhet të jetë shumë më serioze dhe ligjet që janë kundërthënëse njëra me tjetrën mos t'i procedojë në këtë Kuvend, për shkak se na bjen në një situatë absurde dhe në të miratojmë ligje kundërthënëse këtu.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. A doni replikë, zoti ministër? Jo. Zoti deputet, ka përfunduar debati për këtë, ju lutem.

Komisioni për buxhet, unë e kam me shkrim, ka konstatuar që ligji nuk ka implikime buxhetore. Prandaj, ministri është dashur me Komisionin për buxhet me i pastrue këto gjëra. Do të thotë nuk qëndron... Defakto me shkrim dhe me konstatime nuk qëndron. Po, urdhëro, po si jo. Ti je shef i Grupit...

SABRI HAMITI:

Të dëgjojmë njëri-tjetrin dhe të bëhemi serioz n'do gjëra se nuk na ka hije mos me qenë serioz, edhe ky zotnia i Komisionit të buxhetit, edhe tjerët. Mos i shtini vesht n'lesh. Nëse ju keni thënë që s'ka implikime buxhetore dilni thoni që s'ka implikime në këtë variant, e jo në tjetrin. Dhe mos i hutoni deputetët dhe bënu të vetëdijshëm çka po dëgjoni e çka po thoni. Nuk ka implikime në variantin e propozuar - po, por t'dihet!

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Urdhëro Hydajet.

HYDAJET HYSENI:

Tash edhe unë jam pak i hutuar dhe s'po e marr vesh kush kujt po i shet mend. Por, po e lëmë këtë. Po nëse shet mend edhe ta kthejnë.

Kishte një propozim këtu, të cilin mendoj nuk mund ta anashkalojmë ashtu. Dhe mendoj duhet shqyrtuar. Në përputhje me nenin 27, deputeti ka të drejtë... që një çështje të hiqet prej shqyrtimit, të shtyhet dhe në raste të tilla ajo hidhet në votim. Unë prandaj po kërkoj që kjo të rrespektohet.

E dyta. Edhe unë mendoj se duhet ta rrespektojmë edhe praktikën e deritashme sipas të cilës amendamentet kanë qenë të radhitura dhe vetëm në këtë mënyrë ne mund t'i shqyrtojmë dhe për t'i shqyrtuar kështu duhet edhe për një arsye – që të mos lejojmë ato pastaj të na kthehen pas ndonjë jave dhe t'i shqyrtojmë me procedurë urgjente dhe jodenjëtoze. Ju falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Dragisha Krstoviq, në emër të Grupit Parlamnetar.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Gospodine predsedniče, dame i gospodo poslanici,

I sam sam na samom početku bio zbunjen pa sam kod Službe tražio objašnjenje šta je te u materijalu nema sistematizovanih amandmana na način kako je to do sada radjeno, što je bilo, moram priznati dosta dobro, mada je imalo nekih nedostataka kad su bili u pitanju amandmani na isti zakonski tekst ili amandmani koji su se medjusobno isključivali. Ovo je sada zbilja zabuna i apsolutno podržavam gospodina Dugolija i gospodina Hisenija da ćemo se veoma teško snaći. Ja sada prosto ne znam – da li je tekst u amandmanu 1. tekst koji je predložila Koalicija «Povratak» ili profesor Selmani, tako da ćemo prilikom glasanja veoma teško da se snalazimo barem mi iz Koalicije «Povratak».

Predložio bih da se ovo skine sa današnjeg dnevnog reda i da se pripremi na način kako je do sada to radjeno, da se ne bi pravila zabuna i velike dileme. Hvala.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Meta.

HASAN META:

I nderuari kryetar, zonja dhe zotrinj deputet,

Unë jam i mendimit që të përfillen mendimet e shumë atyre që folën këtu dhe piksëpari do të ndalem në diskutimin e parë të deputetit Bedri Selmani që ka plotësisht të drejtë dhe ka bërë një analizë shumë të mirë të Projektligjit dhe ka dhënë amendamente të bollshme dhe të qëlluara.

Në rendin e dytë, e përkrahi zotin Dugolli, i cili dha vërejtjen e cila duhet të përfilllet këtu. Sepse, na del çështja se... Por edhe zoti ministër e patë mirë që i ka përmendur dy variantet. Ju lutem, se gati harrova. Por, me një vërejtje – në Qeveri nuk ka shumë njerëz. Janë disa ministra, kanë mund të merren vesh në mes veti dhe me të vërtetë, siç e tha edhe zoti Daci, t'na bijnë ligjin siç duhet e të jetë konpatibil me Bashkësinë Evropiane.

Por unë e kam propozimin e këtillë. Nëse ne sot votojmë, që po insistojnë shumica, shumica edhe gabim mund të votojnë nëse insiston, atëherë ne po votojmë me atë, domethënë ajo votë është e këtij Komisionit legjislativ, nuk është e deputetëve, sepse nuk e kemi as radhitjen e amendamenteve që mund të zgjedhim cili për të cilin të votojmë. Dhe propozoj që me të vërtetë kjo të shtyhet, të rregullohet edhe çështja me Ministrinë ku ka implikime atje të buxhetit e tjera dhe të na vijë si duhet, por të merren parasysh të gjitha amendamentet e deputetit Bedri Selmani. Falemnderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Ju lutem do të bëjmë pauzë prej 15 minuta. Kryetarët e grupeve parlamentare do të kanë takim me mua.

(Vijoi pauza)

- - -

(Pas pauzës, seanca vazhdoi punën)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ju lutem, po vazhdojmë.

Gjatë pushimit të shkurtër, të gjithë udhëheqësit e grupeve parlamentare ishin të pranishëm. Nuk mundëm të arrijmë një konsensus. Ka dy propozime, të ndara. Propozimet do t'i qes me radhë, sepse kështu kemi ardhë në mbledhje, dhe është që të vazhdohet e ta kryejmë punën. Propozimi tjetër, arsyet i ka dhe argumentet i ka se ka shumë pakjartësi. Ka çështje që do ta zgjasin në pafund debatin edhe për ligjet tjera, do të thotë nuk është çështja vetëm e pikës në shqyrtim. Prandaj mendojnë se duhet të shtyhet dhe të skjarohen disa çështje.

Mua më mbetet vetëm me pyet Parlamentin. Ju jeni ata që vendosni. Deputetët janë ata që do të vendosin. Unë do të abstenoj kësaj radhe – s'do të jam as kundër as për.

Kush është që të vazhdohet seanca plenare me rendin e ditës me të cilin kemi filluar punën?

Ju lutem të deklaroheni. Le të numrohen votat dhe s'kemi nevojë ta tensionojmë çështjen. Ministrat janë deputetë - kanë të drejtë.

Së pari numëroni sa deputetë janë të pranishëm, ju lutem.

99 deputetë janë të pranishëm. 48 deputetë janë që të vazhdohet puna.

Prandaj, unë interpretoj se nuk mund të vazhdohet.

(Polemikë)

Ju lutem, dy vite dhe po hyjmë në vitin e tretë – kam punaur mbi këtë princip. Asnjë propozim, asnjë propozim - derisa ta udhëheqi unë Parlamentin - që nuk e ka shumicën e të pranishmëve nuk kalon, pa marrë parasysh a e kam bë unë propozimin apo dikush tjetër.

Unë ju falënderoj. A e kam gabim apo jo, unë nuk kam njëqind standarde, ju kam thënë një herë – kur t'më konvenon një herë kështu e një herë ashtu! Prandaj, profesor ju falemnderit shumë për këshilla.

SABRI HAMITI:

Jo, jo këshilla. Nuk është këshillë, por këtë e kam të drejtë në emër të Grupit.

Ky është moment shumë interesant dhe mua po më pëlqen shumë, me ju thënë të drejtën. Pse? Sepse, dy anëtarët e Kryesisë që është e vërtetë s'janë të partive të njëjta bëjnë be shpesh në emër të procedurës dhe na lodhin shpesh duke i interpretuar. Unë i thërras të dytë – le ta çelin atëfarë rregulloreje dhe le të shohin, edhe atë kornizë që punojmë ne kishe në bazë të saj e që del rregullorja. Nëse është kjo kështu, unë kërkoj falje. Unë e di që nuk është kështu, sepse shumica krijohen me shumicën e atyre që votojnë. Kështu që, ju e dini shumë mirë – nëse ju konvenon mos me vazhdue mbledhjen, ju bëftë mirë, s'ka problem – vijmë tjetrën herë, por veç dola ta theksoj këtë dhe pakashumë t'ju preku në sedër.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Profesor, ju falemnderit shumë për udhëzime e për... Unë t'hash, viti i tretë i udhëheqjes time në Parlament është ky parim dhe do të përfundon derisa ta udhëheq unë. Nuk ka vendim kurrë pa 50 mbi 50% të të pranishëmëve – kurrë. Nuk kemi lejuar asnjëherë. Numri, pa marrë parasysh ai që nuk voton, ai që nuk voton "për" nuk mund të llogaritet që ka mendim tjetër.

Ju lutem ju do të merrni ftesën. Seanca ndërpritet me këtë.

Mirëupafshim në ndërtesën tonë me rend të ditës të shqyrtuar në Kryesi dhe të skjaruar për të gjitha çështjet që janë shtruar. Ju falemnderit.

Seanca u ndërpre në orën 12,15.

E transkriptoi RT (fq:1-18)Zyra E-04, tel. 038-211-860